



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / РЕПУБЛИКА КОСОВО	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS МИНИСТАРСТВО ЖИВОТНЕ СРЕДИНЕ, ПРОСТОРНОГ ПЛАНИРАЊА И ИНФРАСТРУКТУРЕ MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Nr. i org. Org. Jedinica Org. Unit	01
Nr. i Faqeve Br. Stranica No. Pages	01
Nr. i Prot. Proj. Prot. Prot. No.	9714
Datar Datum Date	20.12.23
PRISHTINË / А	
No.2	

Ministria e Mjedisit ,Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Zivotne Sredine, Prostornog planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment , Spatial Planning and Infrastructure

Zv.Ministri i Ministrisë së Mjedisit Planifikimit, Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2), të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/ 01 mars 2019), bazuar ne dispozitat e nenit 7 (paragrafi 2) të Udhëzimit Administrativ Nr.06/2016 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 09/2013 për rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit në transportin ndër urban të udhëtarëve me autobus dhe nenit 8 (paragrafi 3) të Rregullores nr. 14/2023 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenin 131 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenin 5 dhe 21 të Ligjit nr.04/L-179 për Transportin Rrugor, nenin 7 të Udhëzimit Administrativ 09/2013 për rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit të transportit ndërurban të udhëtarëve me autobus dhe rekomandimit të komisionit profesional, nxjerr këtë:

VENDIM

I.REFUZOHET ankesa nr.8813 të datës 16.11.2023 parashtruar nga Shoqata e operatorëve të transportit rrugor të udhëtarëve me autobus “DRENASI” me seli në Drenas, kundër vendimit nr.8423 të datës 03.11.2023 mbi shpalljen e nisjeve të lira ndër-urbane nëpër regjione respektivisht nisjeve ne relacionin **Drenas - Prishtine** dhe anasjelltas.

ARSYETIM

Komisioni i emëruar nga Ministri sipas vendimit nr.8973 datë 22.11.2023 pas shqyrtimit të ankeses, verifikimit të dokumentacionit dhe shkresave të tjera të lëndës dhe duke u bazuar në legjislacionin në fuqi repektivisht nenet 5 (paragrafi 4) dhe 7 të Udhëzimit Administrativ nr. 09/2013 mbi rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit të transportit ndërurban të udhëtarëve me autobus, poashtu duke pasë parasyshë faktin se nisjet e lartecekura ne relacionin Drenas - Prishtine dhe anasjelltas jane pjese e rrjetit aktual dhe te nejtat jane te rendesishme per qytetaret e regjionit respektiv me qellim te krijimit te kushteve per levizje me te lehte te qytetareve te cilet shfrytezojne sherbimet e transportit publik te udhetareve me autobus dhe njekohesisht nuk pengojne ne nisjet ekzistuese te vertetuara nga MMPHI.

Andaj në bazë të kësaj që u tha më lartë vendimi është marrë si në dispozitiv.

Këshilla Juridike:

Kundër këtij Vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtrojë padi në Gjykatën kompetente në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimet të këtij vendimi.

I dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Parashtruesit të ankesës;
- Departamentit të Transportit Tokësor;
- Arkivit të MMPHI -së

